



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2020:121000

Datë: 01.12.2021

Numri i dokumentit: 02856187

C.nr.102/20

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtaren Sabaheta Kurteshi dhe bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J. I., nga fshati..., Komuna e Dragashit të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. B. Sh. nga P., Rr. “Q. B.” ../..., kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, të cilën e përfaqëson i autorizuari R. K. nga Dragashi, me bazë juridike kompensimin e shujtave ditore gjatë punës, vlera e kontestit 1,332.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me dt. 01.11.2021, mori, ndërsa me datë 01.12.2021 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit J. I., nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. B. Sh. nga P.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, që në emër të kompensimit të shujtave gjatë punës për ditët e pranisë në punë për 666 ditë pune, nga 2 € për secilën ditë të prezencës në punë, duke llogaritur prej datës 19.04.2017 deri me datën 18.04.2021, t’ia paguajë paditësit shumën e përgjithshme prej 1,332.00 € (njëmijë e treqind e tridhjetë e dy euro), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 270.00 €.

A r s y e t i m

Pretendimet e paleve:

Paditësi J. I., nga fshati..., Komuna e Dragashit përmes përfaqësuesit të autorizuar ka ushtruar padi me 18.09.2020, kundër të paditurës Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale në Dragash, për kompensimin e shpenzimit të ushqimit gjatë ditës (shujtave ditore) të cilën e ka precizuar në seancën me date 01.11.2021 **ku çështjen e ka paraqitur si në vijim:**

Paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (tutje SHFMU) “ R.” në fshatin..., Komuna e Dragashit në pozitën e te punësuarit ne shkollë si mësimdhënës klasor ne pune nga data 01.09.2008 tutje, ka theksuar se e paditura

Komuna e Dragashit përkundër obligimeve dhe të drejtat të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017, konform dispozitave të nenit 35 pika 7 e kësaj marrëveshjeje, nuk ka bërë kompensimin e shujtave ditore dhe atë nga 2 euro për ditët e pranisë në punë, për 666 ditë pune, nga data 19.04.2017 deri më 18.04.2021, shumën prej 1,332,00 €. Në bazë të kësaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj si të bazuar duke e detyruar të paditurën që paditësit, në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të punës (shujtave ditore) për 666 ditë pune, nga 2 € për secilën ditë të prezencës në punë, duke llogaritur nga data 19.04.2017 deri me datën 18.04.2021, shumën prej 1,332,00 €, si dhe shpenzimet e procedurës 104 € për padi, 31 € për taksën gjyqësore dhe për një seancë të mbajtur shumën prej 135 €, që gjithsej janë 270.00 €.

I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: Mbetëmi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke kërkuar nga gjykata që të njëjtën të aprovoj në tersi si të bazuar, duke shtuar se pas administrimit të provave duke patur parasysh bazën ligjore të Ligjit të Punës neni 90, Kontratën Kolektive të dt. 18.04.2017, konkretisht neni 2 par. 1.2, citoj: “ Dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit, në sektorin publik dhe institucionet edukative – arsimore private në tërë territorin e Republikës së Kosovës”, ku kjo vërtetohet dhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AC.nr.1371/2021, qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me anëtarësimin e punëtorëve të arsimit në SBASHK, të gjitha këto fakte tregojnë se padia dhe kërkesëpadija e paditësit është e bazuar dhe i propozoj gjykatës që të aprovon në tërësi kërkesëpadinë e precizuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar duke bërë njëherë edhe specifikimin e tyre.

Përfaqësuesi i të paditurës me autorizim R. K., si në Përgjigjen në padi dhe në deklarinimet e tij në seancën kryesore, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar, se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit, të datës 18.04.2017, përgjegjëse për implementimin e saj është pala nënshkruese, andaj e paditura nuk ka obligim ndaj paditësit, pasi që Komuna e Dragashit nuk është nënshkruese e kontratës kolektive, por të njëjtën e ka nënshkruar Ministria e Arsimit, si dhe nuk janë ndarë mjete buxhetore për realizimin e këtyre obligimeve siç edhe është paraparë në nenin 46 par.1 të Kontratës Kolektive, ku thuhet se “*MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht në Ministrinë e Financave, për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për Komunitat e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm, të përcaktuar me nenin 35, par. 5,7 dhe 9, brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare*”. Mbi bazën e këtyre pretendimeve i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar. **Kurse në fjalën përfundimtare, i autorizuari i të paditurës R. K., mes tjerash ka deklaruar:** Mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe në të gjitha theniet në seancën e shqyrtimit kryesorë me të cilën e kundërshtojmë në tërësi kërkesëpadinë, pasi që e njëjta nuk ka bazë ligjore dhe kërkojë nga gjykata që të refuzohet në tërësi. Në fakt kërkesëpadija bazohet në nenin 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2017 me të cilën është paraparë kompensimi për ushqim për punëtorët e arsimit, mirëpo këtë nen e abrogon përkatësisht e shfuqizon në zbatim neni 46 i kësaj kontrate në të cilën thotë se nënshkruesit e kësaj kontrate MASHT dhe SBASHK-u duhet të angazhohen për ti ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit për zbatimin e dispozitave të nenit 35 par. 5, 7, 9. Gjithashtu konform këtij nenit 46 duhet që bashkë me Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për komuna të Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton se konform këtij neni nuk mund të zbatohet neni 35 par. 7 sa i përket kompensimit të ushqimit për shkak se nuk ka patur ndonjë marrëveshje të shkruar apo ndonjë komunikim qoftë dhe verbal ndërmjet DKA-së – Komunës në këtë rast prej institucioneve përgjegjëse për zbatimin

e nenit 35 sa i përket kompensimit të ushqimit, kjo vërtetohet edhe nga dëgjimi i dëshmitarit Y. E. i cili në dëshminë e tij në mënyrë të qartë thotë se nuk kemi pas kurrëfarë marrëveshje formale apo në mënyrë institucionale që mjetet buxhetore të ndahen për komunat. Andaj i ka propozuar gjykatës që pas vlerësimit të provave të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka lexuar kërkesën. Protokollin 13/402 me nr e dt. 11.08.2020, përmbajtjen e vërtetimit me nr. 58/20, 57/20 të dt. 06.08.2020, leximin e përmbajtjes së vërtetimit nr.168/21 të dt. 02.10.2021 si dhe ka lexuar përmbajtjen e Aktgjykimit AC.nr.1371/2021 të dt. 25.05.2021 dhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese rreth vlerësimit të kushtetutshmërisë së një Aktgjykimi të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Gjithashtu janë lexuar dhe deklaratat e dhëna në cilësinë e dëshmitarëve Y. E. dhe Kryetarit të Komunës së Dragashit Sh. Sh. dhe të drejtorit të DKA-as V. C., deklarata të dhëna në çështjen civile C.nr.102/20

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqësve dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku ka konstatuar se:

Kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar** nga arsyet e cekura si më poshtë:

Nga leximi i kërkesës të dt. 02.12.2020, gjykata vërteton rrethanën se këtu paditësi i është drejtuar Komunës së Dragashit – Drejtorisë së Arsimit, për kompensimin e shujtës ditore, bazuar në kontratën kolektive në fuqi.

Nga leximi i vërtetimit nr. 58/20, 57/20 të dt. 06.08.2020, gjykata konstaton se paditësi është punëtor i SHFMU “ R.” në fshatin R. si mësimdhënës klasor, në punë që nga viti 200 , të dhëna këto të nxjerra në bazë të Librit të punëtoreve me ditë pune vjetore prej 185 ditë. Gjithashtu po sipas këtij vërtetimi gjykata ka vërtetuar se paga bruto e të njëjtit është 500,58 € kurse neto 447,94 €, konstatim ky i Drejtorit të kësaj shkolle .

Nga vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “R.” në fshatin R., nr. 168/21 dt. 02.10.2021, është provuar fakti se paditësi nga data 19.04.2017 e deri me datë 18.04.2021 – ka punuar në institucionin e lartcekur për 666 ditë pune.

Nga leximi i përmbajtjes së Aktgjykimit AC.nr.1371/2021 të dt. 25.05.2021 dhe Qëndrimin të Gjykatës Kushtetuese rreth vlerësimit të kushtetutshmërisë të një Aktgjykimi të Gjykatës së Apelit të Kosovës, është konstatuar nga gjykata rasti nga praktika gjyqësore ku është vërtetuar një vendim në shkallë të parë e që kishte si objekt shqyrtimi pagën jubilarë dhe kompensimin e shujtës, ndërsa nga Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese konstatohet çështja mbi papranueshmërinë e rastit e që ndërlidhen me kontestin nga praktika gjyqësore - rastin objekt shqyrtimi.

Në seancën e shqyrtimit kryesor është lexuar dhe deklarata e dhënë në çështjen civile C.nr.102/20 nga drejtori i DKA-së së Dragashit V. C., ku gjykata ka vërtetuar se i njëjti mes tjerash ka deklaruar: Sa i përket zbatimit të kontratës kolektive palët të cilët kanë nënshkruar SBASHK-u dhe Ministria e Arsimit, të njëjtat nuk janë konsultuar me komunat dhe nuk kanë

marr pëlqimin dhe se shumica nga paditësit nuk janë anëtarë. Vlen të theksohet se lidhur me këtë kontratë përveç asaj që ne e kemi në Web faqen e Ministrisë së Arsimit ku dhe jemi të njoftuar, nuk kemi ndonjë njoftim zyrtarë as prej komunës e as prej Ministrive relevante dhe SBASHK-ut për zbatimin e kësaj kontrate. Sa i përket mësimdhënësve jam njoftuar se kanë bërë kërkesë për pagesë të shujtës.

Nga dëshmia e dëshmitarit – Zyrtar i lartë financiar i DKA-së së Dragashit Y. E., gjykata ka vërtetuar se i njëjti mes tjerash ka deklaruar: Nuk kemi patur biseda individuale me asnjë punëtor lidhur me pagesën e shujtave dhe se sa i përket nënshkrimit të kontratave në mes të Ministrisë së Arsimit dhe SBASHK-ut nuk ka koordinim në mes të DKA-së dhe se ne nuk kemi pas kurrfarë njoftimi lidhur me këtë kontratë. Sa i përket ndarjes së mjeteve për paga dhe mëditje, Komuna nuk ka mundësi të ndaj mjete shtesë pasi që ato ndahen nga Granti qeveritar sipas planifikimit të punëtorëve, ekziston rritja vetëm 0.5% e përvojës së punës, sipas kontratës kolektive dhe jo ndarja për shujtë apo paga jubilarë dhe paga përcjellëse dhe për këtë komuna nuk ka buxhet për të mbuluar shpenzimet e dy nënkategorive të fundit, shujtës, pagës përcjellëse dhe jubilarë. Është e vërtet që kemi pranuar kërkesa prej punëtorëve të arsimit të cilat dorëzohen në zyrën e pranimit të Komunës. Sa i përket zbatimit të kontratës kolektive ne jemi të detyruar të bëjmë zbatimin e tyre por dhe brenda mundësive.

Nga dëshmia e dëshmitarit – Kryetarit të komunës së Dragashit Sh. Sh., gjykata ka vërtetuar se i njëjti mes tjerash ka deklaruar: Neve këtë situatë e kemi të njoftuar dhe për fat të keq që një kohë ballafaqohemi me paditë për kompensim të shujtës, mirëpo ne nuk kemi qenë nënshkruese e kësaj kontrate, ka qenë e vështirë dhe forma e pagesës për ne, e kemi trajtuar seriozisht këtë çështje edhe me nivelin qendrorë - Ministrinë e Arsimit e veçanërisht me Asociacionin e Komunave të Kosovës përkatësisht me Këshillin e kryetarëve të komunave. Në parim ne nuk jemi kundër mirëpo mundësit deri në këtë kohë nuk i kemi pas për të paguar për shkak se dhe në qarkullim e Ministrisë së Financave për pagesa në qarkoren nuk parashihet një kod që të lejon kompensimin e këtyre pagesave. Një çështje tjetër ka qenë edhe rreth neneve të kontratës neni 35 dhe 46 që kanë krijuar një lloj paqartësie të komunës se si të veprohet, kjo e ka sjellë këtë rezultat që të ballafaqohemi me paditë nga mësimdhënësit por normalisht dhe kundërshtimin nga ana e jon të kësaj situatë që shtjellova dhe më herët. Çdo vendim që vjen na jemi të obliguar ti ekzekutojmë. Vlen të ceket se nga ana e Ministrisë së Arsimit kemi kërkuar që këto pagesa ti mbulon kjo ministri apo ministria tjetër përkatëse.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Nga të gjitha faktet dhe provat e administruara, për gjykatën seëdhen në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, sipas kontratës së punës, nuk ishte kontestuese se paditësi është punësuar si mesimdhënes klasor ne shkollën te quajtur “R.” në fshatin R., si dhe është provuar fakti se paditësi nga data 19.04.2017 e deri me datë 18.04.2021 – ka punuar në institucionin e lartcekur për 666 ditë pune. Por lidhur me çështjen në fjalë kontestuese ishte fakti se paditësit a i takon e drejta në kompenzimin e shujtave ditore, për ditët e kaluara në punë për periudhën kohore nga data 19.04.2017 deri me datën 18.04.2021.

Gjykata, nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor ka vërtetuar faktin se paditësi, nga data 19.04.2017 deri me datën 18.04.2021, ka qenë i punësuar si puntor i shkollës “R.” në fshatin R., përkatësisht ka pasur ditët e kaluara në punë për periudhën kohore prej datës

19.04.2017 e deri më datë 18.04.2021 dhe ka 666 ditë pune dhe sipas vlerës 2 euro për një ditë pune, i takon shuma e përgjithshme prej 1,332,00 euro për ditët e punës.

Andaj Paditësi duke konsideruar se i takon e drejta në kompensimin e shujtjeve të ushqimit, pasi që e paditura nuk e ka bërë pagesën e tyre i është drejtuar gjykatës me padi.

Kësisoj, lidhur me vendosjen sipas pikes nën I/ dhe II/ të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata konkretisht u bazua në dispozitën ligjore të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, datë 18.04.2017 (dhe asaj pasuese e datës 22.01.2021) me të cilën është paraparë se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’ua bërë kompensimin”*. Së këndejmi, rezulton se punëdhënësi i paditësit është e paditura në këtë rast, Komuna e Dragashit, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA). Ndërsa, sipas nenit 2 par. 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë shprehimisht precizohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*. Andaj, mbi bazën e kësaj që u paraqit, sipas raportit juridik të paditësit me të paditurën, këtë të fundit e bën plotësisht legjitime dhe me kompetencë për pagesën e detyrimeve sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Po ashtu, me rastin e vendosjes sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata pati parasysh edhe dispozitat ligjore të Ligjit të Punës neni 90 par. 5 të LP-së, sipas të cilës dispozitë ligjore theksohet që *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënësit dhe punëmarrësit të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Rrjedhimisht, edhe sipas kësaj dispozite ligjore, detyrimi për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë (shujtës ditore) i takon punëdhënësit të paditësit, respektivisht të paditurës. Ndërsa në nenet e përmendur më lartë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit që në rastin konkret rezulton të jetë e paditura, t’ia kompensoj ushqimin në punë dhe detyrohet për përmbushjen e të gjitha detyrimeve ndaj paditësit, që dalin nga kjo kontratë kolektive dhe duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk ka argumentuar (me asnjë provë materiale), faktin se e ka të rregulluar çështjen e ushqimit të të punësuarve (në vend punimin – objektin ku punon këtu paditësi), si dhe duke pasur parasysh faktin se nga vërtetimi me nr. 168/21 i lëshuar nga SHFMU “R.” në fshatin R., K. Dragash, me datë 18.10.2021, janë vërtetuar ditët e prezencës në punë të paditësit për periudhën kohore të kërkuar nga i njëjti (19.04.2017 – 18.04.2021 – 666 ditë pune), rezulton se kërkesa e paditësit për një kompensim të këtillë është e themeltë, ashtu që të njëjtit i takon shuma në lartësi prej 1.332,00 euro, marrë parasysh dispozitën e lartcekur, për çka edhe u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, është në fuqi dhe e zbatueshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe se ky dokument kontraktual, prodhon efekt juridik ndaj palëve në procedurë të cilat janë të legjitimuara në kuptimin e legjitimitetit real aktiv dhe pasiv në këtë çështje juridike.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr.16/2012, datë 19.06.2012

(i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditësit në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pretendimet e drejtorit të DKA-se V. C. dhe dëshmimeve të dëshmitareve të dëgjuar si me larte, gjykata nuk ju fali besimin sepse ishin të pa bazuara dhe vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të të paditurës, të paraqitura në përgjigje në padi, dhe gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare se kërkesëpadinë e paditësit gjykata duhet ta refuzoj si të pabazuar me arsyet si me lart nuk i mur për bazë, sepse e paditura nuk arriti të vërtetojë të kundërtën ashtu që e tërë kjo nuk ishte me ndikim për një vendim ndryshe.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mur sipas nenit 452 par. 1 të LPK-së, me ç’rast paditësit iu pranuan shpenzimet siç më poshtë vijnë: për pagesën e taksës gjyqësore për padi, shuma prej 31,00 euro, për përpilimin e padisë shume prej 104,00 euro, dhe për pjesëmarrjen e të autorizuarit të saj në shqyrtimin kryesor, shuma prej 135,00 euro, përkatësisht shuma e përgjithshme prej 270,00 euro.

Andaj nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:121000, 01.11.2021**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, e cila duhet të parashtrohet në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, ndërsa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.